



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 1841/1 Prot.

Tiranë, më 28.12.2020

**V E N D I M**

**Nr. 182, Datë 28 / 12 / 2020**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 113, datë 09.10.2020, të shtetasit L.K kundër “Animus” Kafe Bar, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “identitetit gjinor<sup>1</sup>”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues informon se: *“Në datë 07.10.2020, rreth orës 15.07, së bashku me dy persona të tjerë kanë qenë të ulur tek lokali. Kanë pritur rreth 30 minuta dhe kamarieri nuk i ka shërbyer, dhe kur ka dashur të bëjë porosinë, kamarieri i ka thënë se, “nuk i shërbejmë transave”, dhe më pas kanë debatuar me njëri tjetrin. Pas këtij momenti ka pyetur banakieren se, për ç’farë arsye nuk i shërbehet kafe? Banakierja i është përgjigjur se nuk do pronari. Më pas ka telefonuar policinë në numrin, 129 dhe kur është paraqitur policia e ka njoftuar se duhet të largohet për të mos krijuar konflikt. Ankuesi shprehet se, duke qenë figurë publike është ndjerë i ofenduar pasi në lokal kishte klientë të cilët kishin ndjekur situatën dhe ishin tallur”*.

---

<sup>1</sup> Në formularin e ankesës, ankuesi është shprehur se është diskriminuar për shkak të gjinisë, identitetit gjinor dhe orientimit seksual.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe falje publike nga ana e subjektit kundër të cilit është bërë ankesa.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Neni 7 i LMD-së<sup>2</sup>, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.*

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

**Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankesë, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 113, datë 09.10.2020 të shtetasit L.K u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Me shkresën nr. 1372/1, datë 14.10.2020, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka kërkuar informacion nga Animus Kafe Bar, lidhur me pretendimin e subjektit ankues.
2. Me shkresën nr. 1372/4, datë 19.11.2020 “Kujtesë për shkresën nr. 1372/1, datë 14.10.2020”, Komisioneri ka kërkuar përsëri informacion nga Animus Kafe Bar lidhur me pretendimin e subjektit ankues.

<sup>2</sup> Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Me shkresën datë 26.11.2020, Administratori i Animus Kafe Bar, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Animus Kafe Bar, prej disa vitesh ka mbyllur aktivitetin tregtar në QKB. Incidenti i datës 07.10.2020 nuk ka ndodhur tek lokali Animus por tek lokali ngjitur me të, por ata kanë dhënë emrin e lokalit Animus për ta hequr nga vetja”*.

3. Me shkresën nr. 1372/2, datë 14.10.2020, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka kërkuar informacion nga Komisariati i Policisë Nr. 3, Tiranë, lidhur me ngjarjen e ndodhur në datë 07.10.2020.

Me shkresën nr. 7467/1, datë 29.10.2020, Komisariati i Policisë Nr. 3, Tiranë, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Pas verifikimit të bërë, rezulton se me datë 07.10.2020, rreth orës 15.30, është marrë njoftim nga Salla Operative se një shtetas kërkon ndihmën e policisë. Pas marrjes së njoftimit është dërguar shërbimi i policisë i përbërë nga Oficerët e Patrullës së Përgjithshme, F.K dhe Dh.B, të cilët kanë marrë kontakt me shtetasin L.K, i cili ndodhej tek stacioni i autobuzit, para restorant “Piazza” dhe ka ngritur pretendimin se ka qenë ulur së bashku me dy shokë të tjerë tek Bar-Kafe “Animus” dhe kamrieri e banakierja i kanë thënë se nuk mund t’u shërbenin. Më pas patrulla ka marrë kontakt me personelin e lokalit, shtetasen N.H (banakiere), e cila ka sqaruar se nuk ka asnjë konflikt, por nuk mund tu shërbente sepse sipas saj ankoheshin klientët e tjerë se do të largoheshin nga lokali nëse ishin të pranishëm dhe këta shtetas”*.

4. Me shkresën nr. 1642/1, datë 01.12.2020, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka kërkuar informacion nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Tiranë lidhur me të dhënat e subjektit që ushtron aktivitetin tregtar në mjedisin e Animus Kafe Bar.

Me shkresën nr. 201948/1, datë 11.12.2020 Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Tiranë, në mes të tjerash informoi Komisionerin se në mjedisin e Animus Kafe Bar ushtron aktivitetin tregtar, subjekti L.H.

Me shkresën nr. 28136/1, datë 17.12.2020 Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, në mes të tjerash informoi Komisionerin se pas verifikimit në terren, rezultoi se në adresën e kërkuar ushtronte aktivitetin subjekti L.H.

Me e-mail-in datë 10.12.2020, inspektori i çështjes kërkoi nga ankuesi informacion lidhur me saktësimin e lokalit ku ka ndodhur ngjarja.

Subjekti ankues me e-mail-in datë 14.12.2020 ka informuar Komisionerin se lokali ku ka ndodhur ngjarja është me mbulesa ngjyrë portokalli dhe është ngjitur me lokalin që ka tabelën: Shitet biznesi.

5. Me shkresën nr. 1731, datë 14.12.2020, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka kërkuar nga Komisariati i Policisë Nr. 3, Tiranë, verifikimin e saktësisë së informacionit

të dhënë nga ana e patrullës së policisë, lidhur me emrin e lokalit tek i cili ka ndodhur ngjarja e datës 07.10.2020.

Me shkresën nr. 9012/1, datë 22.12.2020, Komisariati i Policisë Nr. 3, Tiranë, në mes të tjerash, informoi Komisionerin se: *“Nga saktësimi i subjektit rezulton se lokali “Animus” është dhënë nga ankuesi L.K, si pikë referimi, pasi lokali ku ka ndodhur incidenti në fjalë ishte ngjitur me lokalit “Animus”, dhe nuk kishte tabel reklamuese me emrin e lokalit (ku është intervistuar shtetasja me iniciale N.H, banakiere), por nga verifikimi i kryer rezulton se incidenti ka ndodhur në lokalit bar kafe “Dream’s””*.

Në datë 22.12.2020, subjekti ankuesi ka paraqitur një deklaratë me shkrim me anë të së cilës ka deklaruar se tërhiqet nga ankesa sepse ka ngatërruar subjektin kundër të cilit ka bërë ankesën, i cili nuk është “Animus” Kafe Bar por është lokali ngjitur me të, me tabelë “Lavazza”, me tendë ngjyrë portokalle.

Në nenin 90/3 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet se: *“Përfundimi i procedurës administrative: 3. Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”*.

Në nenin 94/1 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet se: *“Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës: 1. Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”*.

Komisioneri konstaton se procedura administrative konkrete ka filluar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga ankuesi L.K, i cili me anë të deklaratës së datës 22.12.2020 është tërhequr nga ankesa.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri çmon se jemi në kushtet e nenit 90/3 dhe 94/1, të Kodit të Procedurave Administrative dhe për rrjedhojë procedura administrative për shqyrtimin e ankesës duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për shkak se ankuesi është tërhequr nga ankesa.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 32, pika 3, nenin 33, pika 10 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## **V E N D O S I :**

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 113, datë 09.10.2020, të paraqitur nga ankuesi L.K kundër “Animus” Kafe Bar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**